



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 25
Prishtinë, më 12.6.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Dukagjin Gorani, Evgjeni Thaçi-Dragusha, Sërgjan Mitroviq dhe Zafir Berisha.

Munguan: Aida Dërguti, Visar Ymeri, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe Elmi Reçica.

Pjesëmarrës nga MPJ: Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër dhe ministër i punëve të jashtme me bashkëpunëtorët: Rejhan Vuniqi, Sami Kastrati, Muhamet Brajshori, Fitim Sadiku, Florent Muçaj dhe Prindon Sadriu.

Pjesëmarrësit e tjerë: Butrint Berisha, PIPS, Rita Nushi, KDI, praktikantë dhe media.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 18 maj dhe 1 qershor 2018;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli;
4. Të ndryshme.

1. Miratim i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli;

Vjosa Osmani-Sadriu, e falënderoi ministrin për përgjigje në ftesën e komisionit dhe për raportin me shkrim për deputetët.

Behgjet Pacolli, theksoi se Republika e Kosovës është e njohur nga 116 vende në shtrirje globale dhe se ky proces është i pandalshëm. Ai njoftoi për vizitat që ka pasur në vendet të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe bëri të ditur për njohjen e Kosovës nga Madagaskari dhe Barbadosi, ndërsa bëri të ditur se edhe disa vende të rëndësishme janë duke e shqyrtuar procesin e njohjes për të cilat tha se nuk do të përmend emrat e tyre, duke pasur parasysh ndërhyrjen në këtë proces nga Beogradi, i cili ka për synim tërheqjen e njohjeve të Kosovës.

Z. Pacolli njoftoi për angazhimet në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me vendet të cilat e kanë njohur Kosovën dhe se deri më tani, tha ai, se Kosova ka marrëdhënie diplomatike me 92 shtete me synim që kjo shtrirje të jetë më e gjerë.

Ai njoftoi për akreditimet e reja të ambasadorëve, për hapjen e ambasadës në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe për ambasadat e reja të cilat priten të hapen së shpejti, ndërsa vuri në pah edhe fushatën agresive të Serbisë dhe aleatëve të saj për të revokuar njohjet e Kosovës dhe ndërmarrjen e masave për të adresuar këtë sfidë. Serbia po përdor instrumente të ndryshme financiare, bursa, votën e tyre në OKB e mjete të tjera për t'i bërë presion vendeve të tërheqin njohjen ose të mos e njohin Kosovën.

Pacolli bëri të ditur se janë vendosur kontaktet dhe se janë duke punuar që Ukraina të njohë pasaportat e Kosovës, e po ashtu, njoftoi edhe për angazhimet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe vizitat me homologë në shumë vende.

Vjosa Osmani-Sadriu, duke u ndërlidhur me çështjen e rotacionit në shërbimin e jashtëm dhe kuotën 50% me 50%, theksoi se edhe tërheqja e 9 ambasadorëve nuk ka ndikuar që të rritet kuota e të emëruarve të karrierës. Nga 4 propozimet për ambasadorë që kemi marrë nga MPJ-ja, tha se kanë qenë propozime politike. Osmani pyeti ministrin Pacolli se kur do të merren veprimet konkrete që të arrihet kuota 50% me 50% në shërbimin e jashtëm, për emërimin e një ambasadori pa u dëgjuar në KPJDIS dhe propozimin për dëgjimin e një kandidati sërish në komision i cili më parë ka shërbyer në shërbimin e jashtëm dhe është dëgjuar në KPJDIS-ja.

Znj. Osmani Sadriu potencoi se i është premtuar Komisionit se do ti përcillet me shkrim plani i rotacionit, dhe nëse është e nevojshme, ajo tha se Komisioni do ta mbajë në besim.

Behgjet Pacolli, theksoi se përmes rotacionit të emërimeve do të angazhohet që të arrihet kuota 50% me 50% në shërbimin e jashtëm dhe se janë duke vepruar në këtë drejtim. Deri më tani tha se ka pasur dy emërimet për ambasador dhe se asnjë tentativë nga ministri i MPJ-së nuk ka pasur që të interferojë me ndonjë person nga politika ose partia.

Ai theksoi se mandatin e tij do ta dorëzojë me kuotë të përbërjes 50% me 50% në shërbimin e jashtëm. Kjo kuotë, tha se tash për tash nuk ka mund të realizohet dhe se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm të karrierës.

Më pas, ministri Pacolli njoftoi për emrat e ambasadorëve politikë dhe të karrierës, të cilëve iu ka përfunduar mandati dhe që janë ftuar të kthehen.

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se njëri nga kandidatët të cilit i ka përfunduar mandati na është përcjellë për dëgjim në komision, për këtë rast do të kërkohet sqarim me shkrim e po ashtu edhe për rastin e Bullgarisë, në aspektin juridik.

Behgjet Pacolli, rreth këtij rasti tha se mund të jetë bërë ndonjë gabim dhe se këtë propozim do ta tërheqin dhe do ta njoftojnë komisionin. Ai po ashtu njoftoi për emrat e diplomatëve të kthyer të cilët do të akomodohen në ministri. Është planifikuar që deri në fund të muajit gusht të kthehen në MPJ edhe 9 diplomatë të tjerë. Ministri njoftoi se ka mungesë të kandidatëve për ambasadorë dhe se janë duke punuar me Akademinë diplomatike të Gjermanisë, për të ndihmuar në organizimin e disa punëtorive në Kosovë.

Time Kadrijaj, tha se tërheqja e njohjeve të Kosovës përmes aktiviteteve të shtetit serb është shqetësuese për gjithë opinionin. Ajo përgëzoi ministrin për lobimin që ka bërë duke shpresuar se numri i njohjeve do të rritet, e jo të zvogëlohet. Znj. Kadrijaj njoftoi ministrin për procesin e mbikëqyrjes së ligjeve, të cilin është duke e zhvilluar grupi punues i komisionit dhe kërkoi që në MPJ të merren me kërkesën e grupit punues, për këtë çështje.

Dukagjin Gorani, duke u ndërlidhur me raportin me shkrim të ministrit, tha se ai është i përgjithësuar dhe len paqartësi, por edhe shumë hapësirë për diskutim. Shpjegimi i procesit të njohjeve, tha se është pak jo praktik dhe nuk shpjegohen arsyet e mosnjohjes.

Gorani pyeti ministrin se cilat janë arsyet për mosnjohjen e Kosovës dhe se a do të mund të kishim një dokument ku shpjegohen arsyet dhe kërkesat që duhet të përmbushen, në mënyrë që njohja e Kosovës të realizohet.

Lidhur me planin strategjik për anëtarësim në KE, pyeti nëse mund ta kenë deputetët dhe se kur mendohet të aplikohet për anëtarësim. Gorani theksoi se nuk i kupton paragrafët lidhur me Traktatin e Komitetit të Transportit dhe kërkoi shpjegim lidhur me Procesin e Berlinit dhe cila është fuqia dhe interesi ynë brenda procesit të Berlinit.

Behgjet Pacolli, në lidhje e kërkesën për njohje të Kosovës, tha se ne duhet të paraqesim një pasqyrë reale, por shtrohet pyetja , se pse duhet të na njohin neve shtetet e tjera. Ka vështirësi tha z. Pacolli t'i qasësh një shteti për njohje sepse fillimisht ai nuk ta njeh as pasaportën. Kosova nuk mund t' ju ofrojë ndihmë vendeve të tjera sikurse Serbia, e cila shpesh ju ofron ndihmë ushtarake, buxhet për marrëveshje për sjellje në studime të studentëve të huaj etj. Kryesisht i kontaktojmë krerët e shteteve, tha ai sepse ata janë më të kursyer prej diplomacisë serbe. Ne nuk kemi çka tu ofrojmë këtyre shteteve, por jemi duke punuar shumë dhe falë punës së madhe kemi arrit 92 marrëdhënie diplomatike.

Vjosa Osmani-Sadriu, pyeti ministrin se a kanë biseduar me Shqipërinë që ajo në raste të caktuara të ofrojë votën e saj për ndonjë shtet, për ndonjë komision të caktuar në KB.

Behgjet Pacolli, duke u ndërlidhur me pyetjen e kryetares së Komisionit, njoftoi se nuk kanë pasur përkrahjen në këtë drejtim nga Shqipëria përkundër 2 tentimeve, por e falënderoi diplomacinë e Shqipërisë që është konstruktive për Kosovën.

Vjosa Osmani-Sadriu, pyeti se ku janë shpenzuar të hollat e Kosovës për lobim, dhe nëse ato janë shpenzuar për biografi personale të njerëzve të caktuar, sepse MPJ-ja ka një linjë të veçantë buxhetore për lobim, e cila nuk është paraqitur në kornizën e afatmesme të shpenzimeve. Ajo shtoi ky është një fond i madh dhe do të ishte mirë që gjatë këtij raportimi, ministër të na tregoni në detaje se ku ka shkuar ai fond, duke bërë të ditur se një pjesë e këtij fondi ka qenë i MPJ-së dhe një pjesë e Presidencës.

Behgjet Pacolli, duke u ndërlidhur me pyetjen e kryetares njoftoi se Kosova ka një rrjet të bashkëpunëtorëve dhe se janë në proces të lidhjes së disa marrëveshjeve me lobues të ndryshëm të cilët janë rezident në rajone të caktuara. Më tej tha se MPJ-ja është duke krijuar një rrjet të lobuesve për të mundësuar zhvillimin e një diplomacie tek ato shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën.

Dukagjin Gorani, pyeti se pse nuk është i përfshirë edhe në raportin me shkrim të MPJ-së krijimi i rrjetit të lobuesve. Lidhur me dokumentin strategjik i cili përmendet në raport, pyeti se a do të kemi qasje në të dhe se a do t'i prezantohet Kuvendit.

Behgjet Pacolli, sa i përket mospërfshirjes së rrjetit të lobuesve në raport, tha se ai rrjet nuk është për publikun. Lidhur me dokumentin strategjik, tha se në momentin kur vendoset se Kosova do të aplikojë në Këshillin e Evropës, atëherë ai dokument do të adaptohet dhe do t'iu paraqitet deputetëve dhe Kuvendit.

Ai bëri të ditur se ende nuk është vendos data dhe mënyra e aplikimit në KE dhe shtoi se në KE është krijuar një moment i favorshëm për Kosovën, për arsye se janë shumë shtete mike, të cilat do ta kishin ndihmuar këtë proces, mirëpo, duhet një konsensus ndërinstytucional që të vendoset momenti kur të aplikohet për anëtarësim në KE.

Dukagjin Gorani, u interesua për arsyet se pse deri më tani nuk është bërë aplikimi dhe nëse ministri mund të tregojë datën e përafërt të aplikimit. Ai po ashtu tha se nëse nuk mendoni se duhet të aplikohet, cilat janë arsyet e mosaplikimit.

Behgjet Pacolli, tha se duhet të ketë një konsensus gjithëkombëtar dhe institucional në Kosovë që vendos për aplikim. Ne kemi rekomandime nga miqtë tanë, shtetet e Kuintit, që të mos aplikojmë tani, për arsye se rezultati do të jetë negativ, njoftoi ministri.

Dukagjin Gorani, duke iu referuar raportit të MPJ-së, i cili në një pjesë të tij thotë: “Një deklaratë tjetër e nënshkruar nga Ministri i Punëve të Jashtme duhet të deponohet edhe tek shteti depozitar në momentin që krijohet Sekretariati” kërkoi sqarime se çfarë nënkupton kjo?

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se nuk është synimi i komisionit ta dëmtojë pozicionin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ne kemi kërkuar që të jemi pjesëmarrës në grupin punues për anëtarësimin e Kosovës në KE dhe kemi kërkuar që në momentin kur plani strategjik është gati ta kemi edhe ne si komision.

Behgjet Pacolli, sa i përket komisionit njoftoi se ai është formuar dhe se pjesëtarët e këtij komision janë edhe anëtarët e shoqërisë civile. Dokumenti tha, se është pothuajse i gatshëm vetëm duhet të vendoset për të aplikuar dhe si të aplikojmë. Në momentin që do ta kemi datën do ta ndajmë me juve raportin, tha ministri.

Ai më tej njoftoi se ndikimi financiar mund të ndikojë tek aplikimi i Kosovës në KE, sepse janë disa shtete të cilat e kundërshtojnë Kosovën dhe ato shtete e kushtëzojnë mospranimin e Kosovës me praninë e tyre dhe me fondet e tyre. Sa i përket datës për aplikim ai njoftoi se nuk do të jetë vera e këtij viti dhe se duhet të pritet se si do të zhvillohet situata nga shtatori e tutje.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, shprehu mendimin se MPJ-ja është duke e zhvilluar një aktivitet të ngjeshur në fushën të cilën ajo e mbulon. Nga të gjitha iniciativat që i ka ndërmarrë Kosova për tu anëtarësuar në organizata ndërkombëtare, tha se anëtarësimi i Kosovës në KE i ka gjasat më të mira të ndodhë për shkak të momentumit, por edhe për shkak të aktivitetit të përfaqësuesve të Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të KE-së.

Si pozitive, znj. Thaçi-Dragusha e cilësoi identifikimin e Koresë së Jugut dhe Polonisë si shtete të cilat nuk janë trajtuar kushtimisht mirë, pasi që ato na kanë njohur dhe të cilat mund të ndihmojnë Kosovën. Ajo njoftoi se është kryesuese e Grupit të miqësisë me Poloninë dhe shprehu gatishmërinë që të ndihmojë në zhvillimin e raporteve diplomatike me këtë shtet. Sa i përket deklaratave të përbashkëta të cilat do të dalin nga Procesi i Berlinit, shprehu mendimin se duhet të ketë kujdes tek këto deklaratë, në mënyrë që Kosova të mos marrë më shumë detyrime se sa që ka, apo të humb diçka nga ato që ka arritur me vite. Ajo po ashtu njoftoi se ka pranuar ankesa nga stafi i disa ambasadave dhe konsullatave, dhe po ashtu tha se shqetësim të madh tha se përbën edhe kthimi i 9 diplomatëve, për të cilët duhet të bëhet zgjidhje brenda ministrisë, në mënyrë që të mos shkaktohen probleme.

Behgjet Pacolli, lidhur me problemet e stafit diplomatik, njoftoi se kanë krijuar një komision disiplinor dhe si konsekuencë e këtyre ngjarjeve kanë ndërhyrë tek disa raste dhe janë ndërmarrë masa ndëshkuese për fajtorët.

Sa i përket Procesit të Berlinit dhe deklaratave të cilat do të dalin nga Samiti i Londrës, njoftoi se kjo është një iniciativë e presidencës britanike që këto tri çështje të ngritën. Ai tha se janë munduar që këto çështje të diskutohet në një vend tjetër dhe ti lihet vend samitit për çështjet ekonomike dhe të sigurisë, por insistimi ka qenë i madh që këto tri deklarata të jenë temë e diskutimit.

Z. Pacolli, tha se Kosova që nga konferenca e Vishegradit, Samiti i Sofjes dhe Samiti i Londrës, respektohet dhe konsiderohet si shtet i barabartë me shtetet tjera të Ballkanit. Ai më tej njoftoi se Kosova është duke kaluar në një periudhë shumë të vështirë ekonomike, të integritimeve, të njohjeve, edhe sa i përket obstrukcioneve të Beogradit, dhe shtoi se synimi i tij si ministër është që mandatin e kësaj ministrie ta përfundojë me sukses.

Zafir Berisha, duke iu referuar fjalimit të ministrit lidhur me ulësen në OKB, tha se jo vetëm ministri, por edhe koleget e tij të institucioneve të ndryshme si prioritet e kanë potencuar ulësen në OKB, dhe pyeti se mos ky pretendimi shumë publik dhe insistues për ulëse në OKB, është parapërgatitje e qytetarëve për një pazar të ri. Berisha tha se është e vërtetë që ministria përballat me shumë gjëra të cilat të tjerët nuk i din, dhe shprehu mendimin se ministri duhet të jetë i rezervuar në krahasime me shtete tjera, duke iu referuar raportit në të cilin thuhet se Kosova se ka bërë shumë punë në krahasim me Shqipërinë.

Sa i përket ofensivës serbe kundër njohjeve, pyeti se çfarë është duke ndodhë me politikën e Kosovës, dhe se a ka bashkëpunim në mes të institucioneve dhe garantuesve, pasi që në bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë ka pas marrëveshje që Kosova dhe Serbia të mos e pengojnë njëra-tjetrën, kurse në fakt është duke ndodhur e kundërta. Ai shtoi se Kosova është duke u futur në një fazë të rëndësishme sa i përket bisedimeve me Serbinë.

Z. Berisha për Traktatin e Komunitetit të Transportit tha se është mirë të dimë se çfarë është ai traktat dhe cili ka qenë rezultati i reagimit të ministrisë ndaj asaj mospërfillje që i është bërë shtetit të Kosovës, në lidhje me këtë traktat.

Behgjet Pacolli, sa i përket ulëses në OKB, tha se qëllimi i Kosovës është që të këtë ulëse në OKB, pasi që Kosova si e tillë nuk mund të qëndrojë jashtë Kombeve të Bashkuara, duke shtuar se nuk beson se dikush do të bëjë ndonjë pazar me Kosovën për hir të ulëses në Kombet e Bashkuara. Ministri njoftoi se kanë hyrë disa shtete në Këshillin e Sigurimit, siç janë Gjermania, Belgjika, Afrika e Jugut, të cilat i kanë premtuar se do të jenë dashamirëse me Kosovën.

Sa i përket dialogut, tha se ai duhet të vazhdojë dhe se sa më shpejt të ndodh pajtimi me Serbinë aq më mirë është për Kosovën. Lidhur me Traktatin e Komunitetit të Transportit, njoftoi se ai është nga mandati i kaluar, dhe se kanë insistuar që selia e këtij traktati të jetë në Prishtinë, por pas verifikimit të potencialit që ofron Prishtina, është konsideruar se Beogradi i plotëson kushtet.

Ai po ashtu njoftoi se kanë vënë një kusht që Kosova ta ketë udhëheqjen e këtij traktati. Sa i përket hartave të këtij traktati, tha se aty kufijtë e Kosovës nuk janë paraparë në vija kufitare, por në vija administrative dhe se për këtë kanë protestuar, duke shtuar se kjo çështje duhet të rregullohet para përfundimit të Samitit të Londrës. Ai po ashtu njoftoi se do ta Kosova do ta ketë Drejtorin e Përgjithshëm të kësaj organizate, dhe se ka bërë lidhshmërinë e Ministrit të Transportit me këtë organizatë.

Zafir Berisha, tha se ministri për shkak të agjendës së tij ndoshta nuk e ka dëgjuar deklaratën e zëvendëskryeministrit Hoxhaj, në lidhje me ulësen në OKB dhe me krahasimin dhe rëndësinë që e ka tërhequr me krijimin e asociacionit të komunave serbe. Ai shtoi se Kosova është në dy procese shumë të rëndësishme, lidhur me mekanizmat ndërkombëtarë siç janë anëtarësimi në UNESCO dhe Interpoli, këto tha se janë po aq të rëndësishme sa janë njohjet.

Behgjet Pacolli, njoftoi se kanë qenë nën presion që të sigurojnë pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit të Interpolit në sesionin e Interpolit që është mbajtur në Lion, sepse vota e tyre ka qenë e kushtëzuar me pjesëmarrjen e tyre në këtë sesion. Ai më tej njoftoi se kanë punuar shumë dhe kanë arritur sukses që Kosova të jetë në rend dite. Ai po ashtu njoftoi se kanë arritur të sigurojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Koresë, Nigerisë dhe Singaporit në këtë sesion. Në këtë sesion, tha se kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e Kanadasë dhe SHBA-së, dhe se e kanë pasur të vështirë të sigurojnë votën e Moldavisë, e cila e ka përfaqësuar Evropën.

Z. Pacolli falënderoi ish ministrin Flamur Sefaj, i cili ka bërë një punë të mirë sa i përket Interpolit, po ashtu, tha se në nëntor do të mbahet Samiti i Interpolit, dhe se Kosova do të jetë pjesë e Interpolit. Kjo është një sfidë e madhe, sepse ka shumë shtete që nuk na kanë njohur dhe se ato është duke i motivuar Rusia dhe Kina, të cilat llojnë kundër nesh. Ai njoftoi edhe për takimet bilaterale dhe për delegacionet të cilat i ka pritur në Kosovë.

Vjosa Osmani-Sadriu, falënderoi ish- ministrin Sefaj, i cili ka ftuar Komisionin për Punë të Jashtme që të jetë pjesë e barabartë e këtij procesi dhe njoftoi se komisioni përfaqësohet në grupin punues për anëtarësimin e Kosovës në Interpol.

Sa i përket Traktatit të Transportit, tha se vërejtja kryesore atëherë erdhi nga Komisioni për Integritet Evropian, se është kontaktuar atëherë BE-ja, meqenëse se përveç shtojcave, ku ndarja me Serbinë ka qenë me pika, po ashtu edhe referimi i Kosovës në fusnotë ka qenë në kundërshtim me përmbajtjen që është përcaktuar në marrëveshjen e Brukselit.

Ajo më tej shtoi se është esenciale që t'i bashkohet tekstit të traktatit një deklaratë nga Republika e Kosovës që e shpreh mospajtimin e saj qoftë me hartat, qoftë me deniminim që është përdorë, në mënyrë që pastaj t'i hapet rruga Parlamentit për ratifikim.

Sa i përket Polonisë, tha se në media kanë dalë dekretimet për hapjen e ambasadës në Poloni, dhe pyeti se a e keni marrë paraprakisht pajtimin e Polonisë, që nëpërmjet hapjes së ambasadave dhe shkëmbimit të ambasadorëve, këtë akt ta pranojë edhe si akt të lidhjes së marrëdhënieve diplomatike.

Behgjet Pacolli, sa i përket Polonisë, njoftoi se është takuar me Ministrin e Punëve të Jashtme, dhe se i ka dërguar një notë verbale. Ai më tej tha se një delegacion i Kosovës do të shkojë në Poloni më 29 qershor dhe se përfaqësuesi i MPJ-së do të shkojë me kërkesën për hapjen e ambasadës. Ai bëri të ditur se dekreti ka ardhur tek ne, atë e kemi dërguar nëpërmes ambasadës tonë në Bruksel dhe jemi në pritje. Ai më tej njoftoi edhe për problemin e ngjashëm që e ka pas edhe me shtetin e Nigerisë, për të cilët njohja nuk ndodh me notë verbale, por me shkëmbimin e ambasadorëve.

Vjosa Osmani-Sadriu, sa i përket çështjes së Polonisë tha se, shpresoj që do të kemi pajtim përfundimisht, sepse nga viti 2008 ka qenë kryesisht kundërshtimi i partive konservative dhe ish - Presidenti ka pas një qëndrim negativ sa i përket shkëmbimit të ambasadave.

Sa i përket Procesit të Berlinit, pyeti se a do t'i qëndroni besnik dhe a do të ketë konsistencë në raport me qëndrimin që e ka mbajtur qeveria e kaluar sa i përket tregut të përbashkët ekonomik. Atëherë tha se ka ekzistuar një pajtim në mes të Kryeministrit Edi Rama dhe tash Presidentit Vuçiq, i cili ishte kundërshtuar nga Republika e Kosovës dhe shtoi se sa i përket Kosovës, kjo ka qenë çështje e mbyllur sepse tregu i vetëm i përbashkët i konsideruar dhe i pranuar nga Kosova është ai i BE-së.

Behgjet Pacolli, qëndrimi ynë tha se është se ne nuk mund ta kundërshtojmë një iniciativë të tillë, kjo iniciativë është proces sikurse ekonomia globale. Shprehu mendimi se Kosova duhet të kalojë nëpër fazat e globalizimit dhe nëse Kosova nuk është pjesë e mekanizmit global do ta ketë jashtëzakonisht vështirë të mbijetojë për arsye se rrethanat e kanë kushtëzuar Kosovën për këtë.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se sipas ministrit kjo temë do të rihapet përkundër faktit që është kundërshtuar nga Kosova në mandatin e kaluar dhe është vlerësuar që ekonomikisht Kosova do të dëmtohet, kurse Serbia përfiton.

Behgjet Pacolli, tha se Kosova është pjesë e CEFTA-s, dhe se asgjë jashtë CEFTA-s në tregun e përbashkët nuk pretendohet të bëhet. Nëse pretendohet të bëhet, atëherë bëhet sipas rregullave të BE-së dhe rregullave të CEFTA-s, të cilat jemi duke i respektuar. Ne do të jemi pjesë e një tregu të përbashkët që nuk është një Jugosllavi e vjetër, këtu kemi edhe shtete tjera të cilat synojnë të jenë pjesë e këtij tregu si Bullgaria dhe Greqia.

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se shkak i insistimit të Kosovës në mandatin e kaluar, kjo marrëveshje ka ndryshuar shumë, dhe se është me rëndësi që të mbahet drafti i fundit që është arritur dhe të mos ketë ndryshime të reja, të cilat Kosovën mund ta dëmtojnë ekonomikisht. Ajo bëri të ditur se është me rëndësi që të sqarohet se çfarë pozicioni do të mbajë Kosova në Samitin e Londrës, nëse kjo çështje do të hapet. Sa i përket emërimeve për ambasadorë, kryetarja njoftoi se edhe ambasadorët e karrierës gjithnjë kanë kaluar dhe janë intervistuar në komision dhe se është me rëndësi që të mbahet konsistenca në respektim të procedurave.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

Kryetarja e Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.